

AUTORITETI I ÇERTIFIKIMIT
KONTABILITETI, RAPORTIMI FINANCIAR DHE ANALIZA E PASQYRAVE
FINANCIARE

Teza me Përgjigjet - 2014

I. KONTABILITETI I PERGJITHSHEM FINANCIAR

(70 PIKË)

Ushtrime

Ushtrimi 1

Përgatisni një pasqyrë të fluksit të mjeteve monetare për shoqërinë A në bazë të informacionit financiar të mëposhtëm. (7 pikë)

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2013

mijë Lekë

Të ardhura nga shitja	5,760
Kosto e mallrave të shitura	<u>-2,304</u>
Fitimi bruto	3,456
Shpenzime të tjera operative	-1,278
Shpenzimet administrative	-406
Shpenzimet e shpërndarjes	<u>-548</u>
Fitimi nga veprimtaritë e shfrytëzimit	1,224
Shpenzime interesi	-172
Të ardhura nga investimi	<u>100</u>
Fitimi para tatimit	1,152
Tatimi mbi fitimin	<u>-212</u>
Fitimi pas tatimit	<u>940</u>

<u>Bilanci më</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>	<u>31 dhjetor 2012</u>
	mijë Lekë	mijë Lekë
Aktive AGJ materiale dhe jo-materiale	12,298	11,669
Aktive për investim	1,100	1,000
<i>Aktivët ASH</i>		
Inventarët	266	220

Llogaritë e arkëtueshme	370	340
MM dhe ekuivalentët	<u>184</u>	<u>124</u>
Totali i aktiveve afat-shkurtra	<u>820</u>	<u>684</u>
Totali i aktiveve	<u>14,218</u>	<u>13,353</u>
Kapitali i aksionerëve		
Kapitali aksioner	8,600	8,500
Rezervë rivlerësimi	300	-
Fitimet e pashpërndara	<u>2,320</u>	<u>2,304</u>
<i>Totali i kapitalit të aksionerëve</i>	<i>11,220</i>	<i>10,804</i>

Detyrimet afat-gjata

Hua afatgjatë (8% interes)	2,200	1,900
----------------------------	-------	-------

Detyrimet afat-shkurtra

Detyrime tregëtare për t'u paguar	135	120
Interes për t'u paguar	88	76
Tatim mbi fitimin për t'u paguar	239	189
Dividendë për t'u paguar	336	264
<i>Totali i detyrimeve afat shkurtra</i>	<i><u>798</u></i>	<i><u>649</u></i>
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	<u>14,218</u>	<u>13,353</u>

Shënime

- 1 Në fitimin nga veprimtaritë e shfrytëzimit përfshihet shuma e amortizimit vjetor prej 1,471 mijë Lekësh dhe humbja prej 504 mijë Lekësh nga dalja e makinerisë nga përdorimi.
- 2 Gjatë vitit 2013 shoqëria ka deklaruar dhe shpërndarë dividendë nga fitimet e pashpërndara në shumën 924 mijë lekë.
- 3 Aktive AGJ Materiale dhe JoMateriale

	<u>Ndërtesa</u>	<u>Makineri</u>	<u>Totali</u>
	mijë Lekë	mijë Lekë	mijë Lekë
Kostoja e blerjes më 31 dhjetor 2012	12,000	10,800	22,800
Blerjet gjatë vitit	0	2,880	2,880
Rivlerësimi	300	0	300
Shitjet/daljet nga përdorimi	<u>0</u>	<u>- 1,920</u>	<u>- 1,920</u>
Kosto e rivlerësuar më 31 dhjetor 2013	<u>12,300</u>	<u>11,760</u>	<u>24,060</u>
Amortizimi i akumuluar më 31 dhjetor 2012	1,440	9,691	11,131
Amortizimi i vitit	240	1,231	1,471
Shitjet/daljet nga përdorimi	<u>0</u>	<u>- 840</u>	<u>- 840</u>
Amortizimi më 31 dhjetor 2013	<u>1,680</u>	<u>10,082</u>	<u>11,762</u>

Zgjidhje Ushtrimi nr. 1

Mijë Lekë

Fluksi i MM nga veprimtaritë e shfrytëzimit

Fitimi para tatimit	1,152	
Rregullimet për:		
+ Amortizimin	1,471	}
+ Humbjen nga shitja e aktiveve	504	
- Të ardhurat nga investimet	- 100	
- Shpenzimet e interesit	<u>172</u>	
	3,199	1 pikë
Rritja e llogarive të arkëtueshme	- 30	}
Rritja e inventarit	- 46	
Rritja e detyrimeve për tu paguar	<u>15</u>	
MM të gjeneruar nga veprimtaritë e shfrytëzimit	3,138	1 pikë
Interesi i paguar (76+172-88)	- 160	}
Tatim fitimi i paguar (189+212-239)	<u>- 162</u>	
Fluksi neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit	2,816	1 pikë

Fluksi i MM nga veprimtaritë e investimit

Blerje e AQT	- 2,880	0.5 pikë
Të ardhurat nga shitja e pajisjeve (1,920 – 840 – 504)	576	1 pikë
Fluksi neto i përdorur në veprimtaritë e investimit	- 2,304	

Flukset e parave nga veprimtaritë financiare

Të hyra nga emetimi i kapitalit (8,600 – 8,500)	100	0.5 pikë
Të ardhurat nga huatë afat-gjata (2,200-1,900)	300	0.5 pikë
Dividendët e paguar (264 + 924 – 336)	<u>- 852</u>	1 pikë
Fluksi neto i përdorur në veprimtaritë financuese	- 452	

Rritjet neto në para dhe ekuivalentë të saj

Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të periudhës ushtrimore	<u>60</u>	}
Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre në mbyllje të periudhës	<u>124</u>	
	<u>184</u>	
		0.5 pikë

Ushtrimi 2

Duke përdorur informacionin e dhënë më poshtë përgatisni një pasqyrë të ndryshimeve në kapital për shoqërinë B për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2013 (mos merrni parasysh informacionin krahasues për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2012): (6 pikë)

Tepricat në llogarinë e kapitalit më 31 dhjetor 2012 ishin si më poshtë :

- kapitali aksioner 25 milion Lekë
- prim i lidhur me kapitalin 5 milion Lekë
- rezerva nga rivlerësimi i AAGJ 10 milion Lekë
- fitime të pashpërndara 132 milion Lekë

Në 2013 shoqëria i ndryshoi politikat kontabël për vlerësimin e inventarëve duke ndryshuar në retrospektivë vlerën e inventarit në rritje me 4 milion Lekë.

Përvec kësaj, gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare për 31 dhjetor 2013 u identifikuan edhe elementët e mëposhtëm:

- vlera kontabël e ndërtesës së shoqërisë ishte rritur më 16 milion lekë;
- vlera e tokës për investim ishte rritur me 14 milionë lekë;
- borxhi i keq ishte rritur me 8 milion lekë;
- interes i pakicës krijuar nga konsolidimi i një shoqërie të kontrolluar 2 milionë lekë;
- diferenca të parealizuara nga konvertimi i pasqyrave financiare të shoqërisë së kontrolluar ishin llogaritur 12 milionë lekë.
- Në 2013 asambleja e aksionerëve miratoi një shpërndarje të dividendëve në shumën 32 milion lekë, por këto dividendë nuk ishin paguar në datën e bilancit.
- Në 2013 u miratua nga asambleja zmadhimi i kapitalit me vlerë 14 milionë lekë, nga të cilat 10 milionë nga fitimi i pashpërndarë dhe 4 milionë nga emetimi i aksioneve të reja.
- Fitimi neto i realizuar nga shoqëria në vitin 2013 ishte 24 milionë lekë.

Zgjidhje Ushtrimi nr. 2

	Kapitali aksionar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva nga rivlerësimi	Fitime të pashpërndara	Totali
	mil. Lekë	mil. Lekë	mil. Lekë	mil. Lekë	mil. Lekë
Teprica e celjes në 31 dhjetor 2012	25	5	10	132	172
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabile				4	4
Teprica e rregulluar	25	5	10	136	176
Teprica nga rivlerësimi i pasurisë			16		16
Fitimi i periudhës				24	24

Dividendë të deklaruar				-32	-32
Emetimi i kapitalit aksionar	4				4
Emetimi i kapitalit aksioner nga fitimet e pashpërndara	10			-10	0
Teprica e mbylljes më 31 dhjetor 2013	39	5	26	118	188

Shënim :

- informacioni mbi të ardhurat nga rivleresimi i tokës për investim nuk ka lidhje me përgatitjen e kësaj pasqyre; kjo e ardhur është pasqyruar në fitimin e periudhës ushtrimore aktuale. **0.5 pikë**
- informacioni mbi borxhet e dyshimta nuk ka lidhje me përgatitjen e kësaj pasqyre; ky shpenzim është i pasqyruar në fitimin e periudhës ushtrimore aktuale. **0.5 pikë**
- interes i pakicës krijuar nga konsolidimi i një shoqërie të kontrolluar nuk përfshihet në pasqyrën e kapitalit të shoqërisë kontrolluese, por vetëm në pasqyrat e konsoliduara. **0.5 pikë**
- diferenca të përcaktuara nga konvertimi i pasqyrave financiare të shoqërisë së kontrolluar nuk përfshihet në pasqyrën e kapitalit të shoqërisë kontrolluese B, por vetëm në pasqyrat e konsoliduara. **0.5 pikë**

Ushtrimi 3

Më 1 janar 2011 një njësi ekonomike bleu për 50,000 lekë një patentë që skadon për 10 vjet. Produkti i mbrojtur nga teknologjia e patentuar pritet të jetë një burim fluksesh monetare neto për të paktën 10 vjet. Njësia ekonomike ka një angazhim nga një palë e tretë për ta blerë këtë patentë në pesë vjet për 70% të shumës që njësia ekonomike pagoi për patentën, dhe njësia ekonomike synon t'ua shesë patentën kësaj pale në pesë vjet. (4 pikë)

Kërkohet:

- a) Duke konsideruar një normë skontimi të flukseve të ardhme në vlerën 10%, si do të bëhet regjistrimi i të drejtës për të arkëtuar vlerën e shitjes së patentës?
- b) Sa është vlera kontabël e mbetur e patentës në çdo fund viti?

Zgjidhje Ushtrimi nr. 3

a) Patenta ka një jetë ekonomike prej 10 vjetësh dhe një jetë të dobishme prej pesë vjetësh në njësinë ekonomike. Shuma e amortizueshme do të amortizohet gjatë jetës së tij të dobishme pesëvjeçare, me një vlerë të mbetur të vlerësuar me vlerën aktuale të 70% të vlerës së drejtë të patentës në datën që ajo u ble: $70\% * 50,000 = 35,000$ lekë. Vlera e aktualizuar e vlerës së rikuperueshme të patentës duhet llogaritur në bazë të normës së amortizimit dhe numrit të viteve në momentin e blerjes, si mëposhtë:

$35,000 * \text{VAFI} (10\%, 5) = 21,732.25$ lekë ku: VAFI – Vlera Neto e Faktorit të Interesit

Njësia ekonomike kontabilizon në vitin e parë të drejta të arkëtueshme dhe të ardhura nga shitja e patentës në vlerë të barabartë me vlerën aktuale të vlerës së rikuperueshme.

D Të drejta të arkëtueshme 21.732,5
K Të ardhura nga shitja 21.732,5

dhe në çdo fund viti llogarit të ardhura financiare nga vlera në kohë e parasë për vlerën e rikuperueshme:

viti i parë – 2,173.2 lekë (21.732,5 * 10% = 2.173,25)
viti i dytë – 2,390.5 lekë { (21.732,5 + 2.173,25) * 10% = 2.390,5 }
viti i tretë – 2,629.6 lekë { (23.905,75 + 2.390,5) * 10% = 2.629,62 }
viti i katërt – 2,892.6 lekë njësoj
viti i pestë – 3,181.8 lekë njësoj

Kontabilizimi vazhdon....

D Të drejta të arkëtueshme 2.173,25
K Të ardhura financiare 2.173,25

E kështu me rradhë për çdo vit.....

1 pikë

b) Blerja e patentës kontabilizohet:

D Patenta (AGJ-JM) 50.000
K furnitori 50.000

Ndërsa amortizimi vjetor do të llogaritet për çdo vit si më poshtë:

$$(50.000 - 21.732,25) / 5 = 5.653,5 \text{ lekë}$$

Nëse ka ndonjë tregues se patenta është zhvlerësuar në çdo datë raportimi, patenta do të rishikohet për zhvlerësim.

Vlera e mbetur e patentës çdo fund viti, sipas modelit të kostos së amortizuar, do të jetë diferenca mes kostos së blerjes dhe amortizimit vjetor si dhe ndonjë zhvlerësimi të akumuluar.

Ushtrimi 4

Për secilin nga rastet e mëposhtme, përcaktoni nëse plotësohen apo jo kushtet e njohjes së aktivitetit, apo kapitalit neto duke argumentuar shkurtimisht mendimin tuaj. (4 pikë)

- Punonjësit e njësisë kanë zhvilluar një sistem informatik të mbajtjes së inventarit vlera e të cilit në 31.12.2013 nuk mund të matet. A do të njihet aktivi?
- Njësia ka një marrëveshje për të pranuar kthimet e mallrave difektozë të shitur. A do të njihet detyrimi?
- Provizioni për llogaritë e arkëtueshme të dyshimta njihet në masën 100% për borxhet mbi 365 ditë vonesë. A do të njihet aktivi?
- Njësia ka blerë mallra, shlyerja e të cilave do të bëhet me këmbim të mallrave të tjerë. A do të njihet detyrimi?

- e) Njësia ka blerë mallra, shlyerja e të cilave do të bëhet me para, por vlera e pagesës nuk është përcaktuar ende. A do të njihet detyrimi?
- f) Emri i mirë është krijuar brenda njësisë. A do të njihet aktivi?
- g) Janë emetuar 100 aksione të zakonshme me vlerë nominale 1000 Lek secila. A do të njihet kapitali neto?
- h) Ndërtesa është blerë dhe njësia ka filluar ta përdorë, por titulli i pronësisë do ti kalojë vetëm pas pagesës së plotë të çmimit. A do të njihet aktivi?

Zgjidhje Ushtrimi nr. 4

- a) Punonjësit e njësisë kanë zhvilluar një sistem informatik të mbajtjes së inventarit vlera e të cilit në 31.12.2013 nuk mund të matet. A do të njihet aktivi?

Jo, aktivi nuk do të njihet sepse nuk plotësohet një nga kushtet kryesore për njohjen e aktivitetit, që është matja me besueshmeri e vlerës së aktivitetit. **(0.5 pikë)**

- b) Njësia ka një marrëveshje për të pranuar kthimet e mallrave difektozë të shitur. A do të njihet detyrimi?

Po, njësia do të njohe një detyrim në formën e provizionit për kthimet brenda garancisë sepse ekziston detyrimi kontraktual dhe vlera mund të perlllogaritet bazuar në historikun e kthimeve

(0.5 pikë)

- c) Provizioni për llogaritë e arkëtueshme të dyshimta njihet në masën 100% për borxhet mbi 365 ditë vonesë. A do të njihet aktivi?

Po, aktivi do të njihet në formën e llogarive të arkëtueshme neto, pas zbritjes së provigjioneve për llogaritë të dyshimta, pasi vlera e tyre mund të matet me besueshmeri në masën 100% për llogaritë me vonesë më shumë se 365 ditë.

(0.5 pikë)

- d) Njësia ka blerë mallra, shlyerja e të cilave do të bëhet me këmbim të mallrave të tjerë. A do të njihet detyrimi?

Po, detyrimi do të njihet, sepse ka lindur detyrimi si pasoje e marrëveshjes kontraktuale dhe vlera e detyrimit (edhe pse jo në mjete monetare) mund të matet me vlerën e drejtë të mallrave të cilat do të shkëmbehen duke rezultuar në burime që dalin nga njësia për shlyerjen e detyrimit.

(0.5 pikë)

- e) Njësia ka blerë mallra, shlyerja e të cilave do të bëhet me para, por vlera e pagesës nuk është përcaktuar ende. A do të njihet detyrimi?

Jo, detyrimi nuk do të njihet, për sa kohë matja me besueshmeri e vlerës si kusht kryesor nuk është përmbushur. **(0.5 pikë)**

- f) Emri i mirë është krijuar brenda njësisë. A do të njihet aktivi?

Jo, emri i mirë i gjeneruar brenda njësisë nuk plotësohet kushtet për njohjen e aktivitetit.

(0.5 pikë)

- g) Janë emetuar 100 aksione të zakonshme me vlerë nominale 1000 Lek secila. A do të njihet kapitali neto?

Po, kapitali do te njihet ne vleren e aksioneve te emetuara pra 100,000 Lek

(0.5 pikë)

- h) Ndërtesa është blerë dhe njësia ka filluar ta përdorë, por titulli i pronësisë do ti kalojë vetëm pas pagesës së plotë të çmimit. A do të njihet aktivi?

Po, aktivi do te njihet perderisa njesia e ka ne perdorim dhe perfiton prej tij burime ekonomike hyrese ne njesi si dhe nese verteton se ka kontroll mbi ndertesen. Njohja e aktivit nuk eshte e kushtezuar detyrimisht nga kalimi i pronesise dhe per me teper nuk kufizohet nga pagesa.

(0.5 pikë)

Ushtrimi 5

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të vitit 2013, njësia ekonomike ka identifikuar një gabim që lidhet me vitin ushtrimor 2012 në lidhje me provizionin për zhvlerësimin e borxheve të këqija. Shpjegoni nëse jemi në kushtet e një gabimi, ndryshimi në politikë kontabël apo ndryshimi në vlerësim kontabël dhe se si do të trajtohet ky ndryshim nga njësia. Ilustroni mendimin tuaj duke paraqitur ekstraktin e pasqyrës së pozicionit financiar dhe pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve për zërat e prekur nëse gabimi është në vlerën 130,000 Lek. Njësia ka përcaktuar një nivel materialiteti prej 1,000,000 Lek. A do të ndryshonte trajtimi nëse vlera e gabimit të identifikuar do të ishte 10,000,000 Lek?

Informacioni i mëposhtëm jepet për secilin prej viteve (në Lek):

(4 pikë)

	31.12.2011	31.12.2012	31.12.2013
Llogari të arkëtueshme, bruto		100,000,000	150,000,000
Provizion për borxhet e këqija	1,500,000	2,000,000	20,000,000

(Shënim: shifrat e mësipërme janë dhënë nga njësia përpara identifikimit të gabimit)

Zgjidhje Ushtrimi nr. 5

Njesia nuk ka ndryshuar politiken kontabel, apo vleresimin kontabel per matjen e provizionit te zhvleresimit te borxheve te keqija, por ka identifikuar nje gabim qe u perket periudhave paraardhese, pra jemi ne kushtet e nje gabimi, kontabilizimi i te cilit do te trajtohet ne perputhje me SNK 8.

(0.5 pikë)

Sipas SNK 8, gabimet korrigjohen ne menyre retrospektive, por ne rast se vlerat e gabimeve nuk jane materiale per pasqyrat financiare, atehere SNK lejon qe gabimet mund te mos korrigjohen retrospektivisht por te njihen prospektivisht ne periudhen ne te cilen identifikohet gabimi.

(0.5 pikë)

Ne rastin e pare vlera e gabimit eshte 130,000 Lek pra eshte nen nivelin e materialitetit te vendosur nga njesia pra kjo vlere mund te futet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve te vitit 2013, vit ne te cilin gabimi eshte identifikuar.

(0.5 pikë)

RASTI 1 – PROVIZIONI NE VITIN E KALUAR KA QENE I NENVLERESUAR

Ekstrakte te pasqyres se pozicionit financiar dhe pasqyres se te ardhurave dhe shpenzime

Pasqyra e pozicionit financiar

(0.5 pikë)

	31.12.2013	31.12.2012
Llogari të arkëtueshme, neto	129,870,000	98,000,000

Humbja njihet ne 2013, pra llogarite e arketueshme neto jane $150,000,000 - 20,000,000 - 130,000 = 129,870,000$

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve

(0.5 pikë)

	Per vitin e mbyllur me 31.12.2013	Per vitin e mbyllur me 31.12.2012
Provigjioni per zhvleresim te llogarive te dyshimta	18,130,000	500,000

Ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kalon diferenca midis dy fondeve te provigjioneve pra per vitin 2013 shpenzimi eshte $18,130,000 = 20,130,000 - 2,000,000$

Ne rastin e dyte, vlere e gabimit eshte 10,000,000 Lek pra eshte mbi nivelin e materialitetit te vendosur nga njesia pra kjo vlere duhet te korrigjohet retrospektivisht duke u futur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve te vitit 2012, vit ne te cilin gabimi ka ndodhur

(0.5 pikë)

Ekstrakte te pasqyres se pozicionit financiar dhe pasqyres se te ardhurave dhe shpenzime

Pasqyra e pozicionit financiar

(0.5 pikë)

	31.12.2013	31.12.2012
Llogari të arkëtueshme, neto	130,000,000	88,000,000

Humbja njihet ne 2012, pra llogarite e arketueshme neto jane $100,000,000 - 2,000,000 - 10,000,000 = 88,000,000$

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve

(0.5 pikë)

	Per vitin e mbyllur me 31.12.2013	Per vitin e mbyllur me 31.12.2012
Provigjioni per zhvleresim te llogarive te dyshimta	8,000,000	10,500,000

RASTI 2 – PROVIZIONI NE VITIN E KALUAR KA QENE I MBIVLERESUAR

Ekstrakte te pasqyres se pozicionit financiar dhe pasqyres se te ardhurave dhe shpenzime

Pasqyra e pozicionit financiar

(0.5 pikë)

	31.12.2013	31.12.2012
Llogari të arkëtueshme, neto	130,130,000	98,000,000

Humbja njihet ne 2013, pra llogarite e arketueshme neto jane $150,000,000 - 20,000,000 + 130,000 = 130,130,000$

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve

(0.5 pikë)

	Per vitin e mbyllur me 31.12.2013	Per vitin e mbyllur me 31.12.2012
Provigjioni per zhvleresim te llogarive te dyshimta	17,870,000	500,000

Ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kalon diferenca midis dy fondeve te provigjioneve pra per vitin 2013 shpenzimi eshte $17,870,000 = 19,870,000 - 2,000,000$

Ne rastin e dyte, vlera e gabimit eshte 10,000,000 Lek pra eshte mbi nivelin e materialitetit te vendosur nga njesia pra kjo vlere duhet te korrigjohet retrospektivisht duke u futur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve te vitit 2012, vit ne te cilin gabimi ka ndodhur

(0.5 pikë)

Ekstrakte te pasqyres se pozicionit financiar dhe pasqyres se te ardhurave dhe shpenzime

Pasqyra e pozicionit financiar

(0.5 pikë)

	31.12.2013	31.12.2012
Llogari të arkëtueshme, neto	130,000,000	100,000,000

Korrigjimi njihet ne ne 2012, pra llogarite e arketueshme neto jane 100,000,000 (sepse provizioni rezulton me rimarrje dhe fondi i provizionit behet 0 me 31.12.2012)

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve

(0.5 pikë)

	Per vitin e mbyllur me 31.12.2013	Per vitin e mbyllur me 31.12.2012
Provigjion / (Rimarrje) per zhvleresim te llogarive te dyshimta	20,000,000	(9,500,000)

Ushtrimi 6

Lidhni secilin prej koncepteve të mëposhtme me përkufizimin përkatës.

(3 pikë)

Konceptet	Përkufizimet
Konstatimi i të drejtave dhe detyrimeve	Vazhdimisht duhen përdorur të njëjtat politika kontabël dhe të mbahet e njëjta paraqitje e pasqyrave
Kuptueshmëria	Efektet e transaksioneve njihen kur ndodhin dhe jo kur paguhen/arkëtohen
Krahasueshmëria	Shmangia e mbivlerësimit të aktiveve dhe të ardhurave dhe nënvlerësimit të detyrimeve dhe shpenzimeve
Rëndësia	Vënia e theksit mbi ato aspekte të veprimtarisë që janë me vlerë për lexuesin e pasqyrave
Maturia	Të qënurit i paanshëm dhe pa gabime materiale
Besueshmëria	Informacioni është informues dhe pa ekuivok

Zgjidhje Ushtrimi nr. 6

Konceptet	Përkufizimet
Konstatimi i të drejtave dhe detyrimeve	Vazhdimisht duhen përdorur të njëjtat politika kontabël dhe të mbahet e njëjta paraqitje e pasqyrave
Kuptueshmëria	Efektet e transaksioneve njihen kur ndodhin dhe jo kur paguhen/arkëtohen
Krahasueshmëria	Shmangia e mbivlerësimit të aktiveve dhe të ardhurave dhe nënvlerësimit të detyrimeve dhe shpenzimeve
Rëndësia	Vënia e theksit mbi ato aspekte të veprimtarisë që janë me vlerë për lexuesin e pasqyrave
Maturia	Të qënurit i paanshëm dhe pa gabime materiale
Besueshmëria	Informacioni është informues dhe pa ekuivok

Shenim: Çdo lidhje ka 0.5 pikë

- 1) Me qellim që të përmbushin qëllimin e tyre, pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj metode, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin dhe jo kur paraqitja arkëtohet apo paguhet.

- 2) Kuptueshmeria – qe informacioni te jete i kuptueshem, ai duhet te paraqitet ne pasqyrat financiare ne menyre te tille qe te jete informues dhe pa ekuiwok, ne menyre qe perdoruesit e pasqyrave financiare qe kane njohuri te mjaftueshme ne fushen e finances, te mund ti kuptojne ato.
- 3) Sipas parimit te rendesise, ne pergatitjen e pasqyrave financiare u duhet vene rendesi atyre aspekteve dhe te dhenave financiare te veprimtarise ekonomike qe jane te rendesishme per perdoruesit e pasqyrave financiare e qe mund te ndikojne ne vendimet ekonomike qe ata marrin.
- 4) Besueshmeria – Per te qene i dobishem, informacioni duhet te jete i besueshem. Informacioni mbart cilesine e besueshmerise, kur ai eshte i paanshem dhe nuk permban gabime materiale si dhe kur perdoruesit mbeshhteten mbi te.
- 5) Parimi i maturise – pasqyrat financiare duhet te pergatiten me maturi dhe kujdes, me qellim qe te shmanget mbivleresimi i aktiveve dhe i te ardhurave, ose nenvleresimi i detyrimeve dhe shpenzimeve.
- 6) Krahasueshmëria – Per pergatitjen e pasqyrave financiare duhet te perdoren vazhdimisht te njejtat politika kontabel, e njejtat paraqitje dhe te njejtat formate te pasqyrave financiare.

Ushtrimi 7

Në 1 janar 2013 njësia ekonomike ABBA mori një hua bankare prej 6 mil lekë për të financuar ndërtimin e dy aktiveve afatgjata, të cilët kërkonin secili një vit për t’u përfunduar. Puna për ndërtimin e tyre filloi gjatë 2013. Huaja u arkëtua më 01 Janar 2013 dhe u përdorën si më poshtë, ndërsa fondet e mbetura u investuan. (4 pikë)

	<i>Aktivi A</i>	<i>Aktivi B</i>
1 janar 2013	250	500
1 korrik 2013	250	500

Interesi i huasë është 9% ndërsa fondet e papërdorura investohen me interes 7%.

Kërkohet:

Duke injoruar interesin e përbërë, të llogariten kostot e huamarrjes të cilat mund të kapitalizohen për çdo aktiv dhe të tregohet vlera me të cilën do të paraqitet secili prej dy aktiveve më datë 31 dhjetor 2013.

Zgjidhje Ushtrimi nr. 7

(Përgjigjet në mijë)

	<i>Aktivi A</i>	<i>Aktivi B</i>
Kostot e huamarrjes		
Deri më 31 dhjetor 2013 (2.000.000 * 9%)	180	
Deri më 31 dhjetor 2013 (4.000.000 * 9%)		360

Të ardhurat nga interesi i investimeve

Deri më 30 qershor 2013 $(1.750 * 7% * 6/12)$	(61.25)	
Deri më 30 qershor 2013 $(3.500 * 7% * 6/12)$		(122.5)
Deri më 31 dhjetor 2013 $(1.500 * 7% * 6/12)$	(52.5)	
Deri më 30 qershor 2013 $(3.000 * 7% * 6/12)$		(100.5)
	66.25	137

Kosto e aktiveve llogaritet si më poshtë:

	<i>Aktivi A</i>	<i>Aktivi B</i>
Shpenzimet për ndërtimin e aktivit	500	1.000
Kostot e huamarrjes	66.25	137
	566.25	1.137

Ushtrimi 8

Në fund të periudhës raportuese (31 dhjetor 2011) rrënjët e një kultivuesi domatesh kanë domate të pjekura. Më 31 dhjetor 2011, vlera e drejtë minus kostot e shitjes së rrënjëve të domateve që do vilen së shpejti matet me 24,000 lekë. Kostoja fillestare e rrënjëve ishte 5,500 lekë dhe kostoja e rritjes së tyre gjatë 2011 (mbjellja, vaditja dhe plehërimi) ishte 7,250 lekë. Njësia ekonomike i voli domatet më 3 janar 2012. Kostoja e vjeljes së domateve është 1,000 lekë. Çmimi i tregut për një kilogram domatesh është 50 lekë dhe kostot e shitjes vlerësohen me 1 % të çmimit të tregut. Njësia ekonomike vjel 500 kilogram domate. Jeta e një rrënje domateje është rreth 6 muaj. Pas vjeljes, rrënja është në fund të jetës së saj dhe vlera e drejtë është e papërfillshme. **(4 pikë)**

Kërkohet:

Si maten dhe regjistrohet transaksionet e mësipërme?

Zgjidhje Ushtrimi nr. 8

Rrënjët dhe fruti i tyre njihen si një aktiv i vetëm biologjik deri në momentin e vjeljes. Më 31 dhjetor 2011, njësia ekonomike e njeh rritjen në aktivet biologjike si rezultat i frutit të domateve që rriten në rrënjë.

Gjatë 2011

Blihen rrënjët e domateve:

D Aktive biologjike të mbajtura me vlerën e drejtë	5,500 lekë
përmes fitimit ose humbjes	
K Furnitori	5,500 lekë

Bëhen shpenzime për rritjen e domateve:

D Shpenzime për kostot e mbjelljes, vaditjes dhe plehërimit	7,250 lekë	
K Mjete monetare		7,250 lekë

Në 31 dhjetor 2011

Njihet rritja në vlerën e drejtë të rrënjëve të domateve:

D Aktive biologjike të mbajtura me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes	18,500 lekë	
K Të ardhura (fitimi nga vlera e drejtë e aktiveve biologjike)		18,500 lekë

Në 3 janar 2012

Njihet kostoja e vjeljes (jo kosto shitje):

D Shpenzime për kostot e vjeljes	1,000 lekë	
K Mjete monetare		1,000 lekë

Njihet inventari i domateve në momentin e vjeljes me vlerën e drejtë minus kostot e shitjes. E gjithë vlera e drejtë e rrënjëve të domateve transferohet te inventari i domateve duke qenë se rrënja e dekompozuar që mbetet në aktivet biologjike ka vlerë të drejtë të papërfillshme:

D Inventari [Domate =500 × 50 Lekë × 99%]	24,750 lekë	
K Të ardhura (fitimi nga vlera e drejtë (me njohjen e prodhimit bujqësor))		750 lekë
K Aktive biologjike të mbajtura me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes		24,000 lekë

Ushtrimi 9

1. Një aktiv me kosto 100 dhe vlerë kontabël neto 80 rivlerësohet për 150. Nuk është bërë asnjë rregullim ekuivalent për qëllime tatimore. Amortizimi i akumuluar për qëllimet tatimore është 30 dhe përqindja e tatimit është 30%. Në qoftë se aktivi shitet për më shumë se kosto, amortizimi tatimor i akumuluar për 30 do të përfshihet në të ardhurat e tatueshme por të ardhurat nga shitja që tejkalojnë koston nuk do të jenë të tatueshme. **(4 pikë)**

Kërkohet:

Të llogaritet dhe të regjistrohet shuma e tatimit të shtyrë.

Zgjidhje Ushtrimi nr. 9

Baza tatimore e aktivit është 70 (100-30) dhe ka një diferencë të përkohëshme të tatueshme për 80 (150-70). Në qoftë se njësia ekonomike pret të rikuperojë vlerën kontabël neto nga përdorimi i aktivit, ajo duhet të gjenerojë të ardhura të tatueshme për 150, por do të mund të jetë në gjendje të zbrisë nga të ardhurat e tatueshme vetëm amortizimin për 70 (baza e tatueshme). Mbi këtë bazë, ka një pasiv tatimor të shtyrë për 24 (80 me 30%). **(1 pikë)**

Në qoftë se njësia ekonomike pret të rikuperojë vlerën kontabël neto nga shitja e aktivitet menjëherë duke gjeneruar të ardhura për 150, pasivi tatimor i shtyrë llogaritet si më poshtë:

(2 pikë)

	Diferenca të Përkohëshme të tatueshme	Përqindja e tatimit	Pasiv tatimor i shtyrë
Amortizimi tatimor i akumuluar	30	30%	9
Të ardhura që tejkalojnë koston	50	zero	zero
Totali	80		9

Tatimi i shtyrë shtesë që krijohet nga rivlerësimi rregjistrohet drejtpërdrejt tek kapitali i vet. **(1 pikë)**

Ushtrimi 10

Kompania shet një Televizor në një paketë së bashku me tre vjet shërbime për 1,000 Lekë. Në qoftë se TV do të shitej pa këto shërbime atëherë çmimi i tij i shitjes do të ishte 900 Lekë. Çmimet e shitjes për të tre vitet e shërbimit për këto lloj TV janë zakonisht 200 Lekë.

(4 pikë)

Kërkohet:

1. Përcaktoni shumën e të ardhurave që do të njihen nga shitja e TV me një kontratë shërbimi
2. Regjistroni të ardhurat nga shitja në këtë rast.

Zgjidhje Ushtrimi nr. 10

1. Të ardhurat nga shitja e TV do të njihen të ndara nga të ardhurat nga shërbimi nëse vlera e tyre është materiale dhe meqënëse ato përfshihen në një paketë të vetme ndarja e tyre do të bëhet sipas vlerës relative të shitjes. **(1 pikë)**

Të ardhurat nga shitja e TV $\{ 900 / (900+200) \} / \times 1000 = 818.2$ lekë **(1 pikë)**

Të ardhurat nga shërbimi të cilat do të shpërndahen në mënyrë proporcionale për tre vite $\{ 200 / (900+200) \} / \times 1000 = 181.8$ lekë **(1 pikë)**

2. Regjistrimi **(1 pikë)**

Llogari të arkëtueshme	1,000
te	
Të ardhura nga shitja e TV	818.2
Të ardhura të papërfituara nga shërbimi	181.8

Ushtrimi 11

Më 1 janar 2007 një qeveri vendore i dha njësisë ekonomike, pa pagesë, një licënsë me vlerë të drejtë 800,000 lekë për të transmetuar në një qytet të caktuar për një periudhë dhjetëvjeçare. Kushtet e dhënies së licënsës kërkojnë që njësia ekonomike të transmetojë lloje të veçanta programesh për të paktën 20 orë në ditë gjatë periudhës së licënsës. Për më tepër, nëse njësia ekonomike nuk e përmbush këtë kusht të performancës, asaj do t'i tërhiqet licënsa menjëherë. **(4 pikë)**

Kërkohet:

1. Regjistrimi marrjen e licënsës.
2. Bëni regjistrimet e duhura kontabël në fund të vitit të parë.

Zgjidhje Ushtrimi nr. 11

1. Më 1 janar 2007 kur njësia ekonomike ka marrë pa pagesë licënsën duhet të njohë një grant qeveritar (detyrim) me vlerën e drejtë të licënsës. **(1 pikë)**

Aktive Afagjata Jomateriale 800,000

te

Grante të shtyra 800,000 **(1 pikë)**

2. Me përmbushjen e kushteve të performancës duke transmetuar llojet e veçanta të programeve për të paktën 20 orë atë ditë, çdo vit njësia ekonomike do të njohë kuotën pjesë të të ardhurave nga granti në shuma të barabarta për 10 vjet duke pakësuar detyrimin për grantin, si dhe të amortizojë licënsën në kuota të barabarta për 10 vjet. Më 31 janar 2007 regjistrimi kontabël do të jetë

Shpenzime amortizimi 80,000

te

Amortizim i akumuluar AAJM 80,000 **(1 pikë)**

Grant 80,000

te

Të ardhura 80,000 **(1 pikë)**

(ose Shpenzime amortizimi)

Ushtrimi 12

Njesia ekonomike A blen nje shoqeri tregtare B per shumen prej AL.L.100,000,000. Per te realizuar kete blerje ajo kryen shpenzime ligjore per te paguar avokatet ne shumen AL.L. 2,000,000. Pra totali i kostove eshte AL.L. 102,000,000. **(4 pikë)**

Kërkohet:

1. Cila eshte kosto e kombinimit te biznesit?

2. Regjistroni ne ditar veprimin.

Zgjidhje Ushtrimi nr. 12

1. Kosto e kombinimit te biznesit eshte totali i kostove qe njesia ekonomike ka paguar, 102 milion

2. Aktive neto 102 milion

Mjete monetare 102 milion

Ushtrimi 13

Shoqeria A sha zotëron 59% të aksioneve të zakonshme të shoqërisë B sha. Shoqeria C shpk zotëron 18% të aksioneve të zakonshme të shoqërisë A Sha. Shoqeria C shpk ka një kontratë furnizimi me lëndë të pare për shoqërinë A sha duke qënë i vetmi furnitor si dhe ka edhe një kontratë konsulence në fushën e mirëmbajtjes së linjës teknologjike të prodhimit të shoqërisë A sha. **(3 pikë)**

Kërkohet:

Tregoni se cilat janë marrëdhëniet midis Shoqërisë A sha dhe Shoqërisë C shpk .

Zgjidhje Ushtrimi nr. 13

Shoqeria C shpk megjithëse zotëron 18% të kapitalit me të drejtë vote të Shoqërisë A sha, është i vetmi furnitor i lëndës së pare dhe po ashtu ka një kontratë mirëmbajtje të linjës teknologjike duke i ofruar ekspertizën e vet. Prandaj Shoqeria C shpk mund të jetë në gjendje të ushtrojë një influence të ndjeshme në Shoqërinë A sha. Kurse vete shoqeria A sha ka kontroll mbi shoqërinë B sha.

Ushtrimi 14

Kompania GAMA ka paraqitur PF te saj me te fundit sipas PPPK-ve te juridiksionit YYZ (per shembull shqiptar) deri ne vitin 20X6. Nga viti 20X7 e ne vijim, per shkak te ndryshimit te kerkesave ligjore e rregullatore, ajo adoptoi SNRF-te. Ne keto kushe ajo eshte e detyruar qe te pergatite bilancin e saj te celjes sipas SNRF-ve per daten 1 Janar 20X6.

Ne pergatitjen e bilancit te celjes sipas SNRF-ve, shoqeria GAMA veren sa vijon:

Sipas PPPK-ve te meparshme shoqeria GAMA ka shtyre kostot e trainimit per shumen 250,000 leke dhe i ka klasifikuar dividendet e propozuar ne shumen 400,000 leke si pasive afatshkurtera. Vec kesaj, ajo nuk ka bere provizion per garanci ne shumen 100,000 leke ne PF, meqenese koncepti i detyrimit kontruktiv sipas PPPK-ve te meparshem nuk ka qene njohur. Dhe se fundi, per te arritur ne shumen qe duhet te kapitalizohet si pjese e kostove te nevojshme qe duhen kryer per ta sjelle aktivin ne kushtet e punes, GAMA nuk kishte pershire as shumen e honorarit profesional prej 50,000 leke, e cila ka qene paguar per arkitektet ne kohen kur u rikonstruktua ndertesa, e cila me pare ka sherbyer si zyre. **(7 pikë)**

Kërkohet:

Te tregohen hapat dhe të zbatohen rregullat e parashikuara ne SNRF 1 per pergatitjen e bilancit te celjes sipas SNRF-ve.

Zgjidhje Ushtrimi nr. 14

Per te pergatitur bilancin e celjes sipas SNRF-ve per daten 01 Janar 20X6, GAMA duhet te beje axhustimet e meposhtme kundrejt bilancit te dates 31 Dhjetor 20X5, i cili ka qene pergatitur sipas PPPK-ve se meparshem. Keto rregullime jepen ne vijim:

1. SNK 38 nuk lejon qe kostot e trainimit te shtyhen, ne kohen qe sipas PPPK-ve te meparshme ky trajtim ka qene i lejuar. Keshtu qe shuma prej 250,000 leke e kesaj kosto te shtyre duhet te cregjistrohet dhe te paraqitet ne shpenzime sipas SNRF-ve **(1 pikë)**
2. SNK 37 kerkon njohjen e nje provizioni per garanci, ne kohen qe sipas PPPK-ve te meparshem ky trajtim nuk ka qene i lejuar. Keshtu qe duhet te njihet nje provizion per garanci ne shumen prej 100,000 leke **(2 pikë)**
3. SNK 10 nuk lejon qe dividendet e propozuar te njihen si nje pasiv, por per to vetem sa duhet te jepen shpjegime ne shenimet shpjeguese. Sipas PPPK-ve te meparshem shoqeria GAMA, ka qene lejuar qe dividendet e propozuar t'i paraqese si pasive afatshkurtera. Keshtu qe dividendet e propozuar ne shumen prej 400,000 leke duhet te eliminohen nga pasivet afatshkurtera dhe per to mjafton te jepen shenime shpjeguese ne pjesen e shenimeve. **(2 pikë)**
4. SNK 16 kerkon qe te gjitha kostot qe jane direkt te atribueshme per te sjelle nje aktiv ne kushtet e tij te punes per qellimin e parashikuar, te kapitalizohen si pjese e vleres kontabel neto te AAM-ve (Toka Ndertesa, Makineri e Paisje). Keshtu qe shuma prej 50,000 leke, e cila perfaqeson honorarin e paguar per arkitektet, duhet qe sipas SNRF-ve, te kapitalizohet si pjese e AAM-ve. **(2 Pikë)**

Pyetje me alternativa (një pikë secila)

1. Në 1/1/2013 njësia jep për punonjësin kredi për blerje automjeti prej 5.000 €uro pa interes për 3 vjet. Banka do të kishte kërkuar 6%. Huaja e arkëtueshme më 1/1/2013 = ??? dhe të ardhurat nga interesi për vitin 2013 = ???
 - a) 4.198 dhe 0
 - b) 4.198 dhe 300
 - c) 4.198 dhe 252
 - d) 5.000 dhe 0
 - e) 5.000 dhe 300

Pergjigja e sakte: alternativa (c)

2. Cili nga të mëposhtmit është *aktiv / detyrim financiar* në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike?
 - a) Një detyrim për një shumë ndaj furnitorit për një furnizim të mëparshëm
 - b) Një e drejtë e lindur nga një parapagim i bërë për furnitorin për një qira 3 mujore për makinerinë

- c) Një detyrim për një gjobë për pagesë të vonuar të tatimit fitimit
- d) Të gjitha të mësipërmet

Pergjigja e sakte: alternativa (a)

3. Pasiv i kushtëzuar është:

- a) një detyrim që krijohet nga ngjarje të shkuara, ekzistenca e të cilit do të konfirmohet vetëm nëse ndodh ose nuk ndodh një ose disa ngjarje të ardhshme të pasigurta, të cilat nuk janë nën kontrollin e plotë të njësisë ekonomike;
- b) një detyrim ekzistues që rrjedh nga ngjarje të shkuara, por që nuk është njohur pasi:
 - ka mundësi që shlyerja e detyrimit nuk do të shoqërohet me dalje të burimeve ekonomike;
 - shuma/vlera e detyrimit nuk mund të vlerësohet me saktësi të mjaftueshme.
- c) Të dyja të mësipërmet

Pergjigja e sakte: alternativa (c)

4. Në përgatitjen e pasqyrave financiare të mikronjësive, aktivet jomonetare dhe detyrimet maten me:

- (a) Kosto
- (b) Vlerë të drejtë
- (c) Kosto ose vlerë të drejtë në varësi të politikës kontabël të zgjedhur nga njësia
- (d) Kosto të amortizuar

Pergjigja e sakte: alternativa (a)

5. Zbatimi retrospektiv, siç kërkohet nga SKK 8, duhet të aplikohet në të gjitha rastet e kërkuara nga Standardi, përveçse kur:

- (a) Është i pazbatueshëm për të përcaktuar qoftë efektet e periudhës së veçantë qoftë efektet e akumuluar të ndryshimit
- (b) Zbatimi i tij rezulton pa leverdi për njësinë bazuar në analizën kosto-përfitime
- (c) Shumat që rezultojnë nga ndryshimi nuk janë materiale për pasqyrat financiare
- (d) Shumat që rezultojnë nga ndryshimi nuk ndikojnë vendimmarrjen e përdoruesve të informacionit financiar

Pergjigja e sakte: alternativa (a)

6. Cili nga elementët e mëposhtëm nuk mund të përdoret për ta përfshirë si zë më vete në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve? (1pikë)

- a) të ardhurat
- b) fitimi bruto
- c) fitimi para tatimit
- d) zërat e jashtëzakonshëm

Pergjigja e sakte: alternativa (d)

7. Investimi neto në qira është:

- a) Investimi bruto i skontuar me përqindjen e normës së interesit të përcaktuar të qirasë.
- b) Investimi bruto i paskontuar me përqindjen e normës së interesit të përcaktuar të qirasë.
- c) Investimi bruto i skontuar me përqindjen e normës së interesit të papërcaktuar të qirasë.

Pergjigja e sakte: alternativa (a)

8. Ne nje operacion te kontrolluar bashkerisht:

- a) Te gjitha aktivet bashkohen.
- b) Sipermarresit perdorin aktivet e tyre dhe burimet e tyre.
- c) Te gjitha aktivet duhet te jene te marra me qira.
- d) Hartimi i Llogarive (PF) individuale eshte i detyrueshem.

Pergjigja e sakte: alternativa (b)

II. KONTABILITETI I KOSTOS DHE DREJTIMIT

(15 PIKË)

Ushtrimi 1

Për shumë vite, kompania Gorski ka prodhuar një produkt të vetëm të quajtur një mono-qark. Tre vjet më parë, kompania ka automatizuar një pjesë të linjës së saj dhe në të njëjtën kohë ka futur një produkt të dytë të quajtur bi-qark që është bërë gjithnjë e më popullore. Bi-produkt është një qark më kompleks se produkti mono-qark, që kërkon dy orë punë direkte për njësi të prodhimit, dhe përpunimit të gjerë në pjesën e automatizuar të uzinës. Përveç kësaj, ky produkt kërkon inspektime të shumta për të siguruar se cilësia e lartë është ruajtur. Mono-qark kërkon vetëm një orë pune për njësi, vetëm një sasi të vogël përpunimi dhe disa të kontrollit mbi cilësinë. Sistemi aktual shpërndan shpenzimet e përgjithshme mbi bazë të orëve të punës direkte. Ndërkohe panvarësisht se produkti bi-qark, ka marrë treg kompania ka vënë re rënie të ndjeshme. Menaxhimi ka filluar të besojnë se sistemi tradicional i kalkulimit të kostos, i cilibazohet në orët e punës direkte, që është përdorur mund të jetë i gabuar. Kostot për njësi për materialeve dhe punës për dy produkteve jepen në vijim:

	Mono-qark	Bi- qark
Materiale	40	80
Kosto pune (18 leke për orë)	18	36

Drejtimi ka vlerësuar se kostot e përgjithshme prodhimit të kompanisë për vitin janë 3.000.000 leke, ndërkohë që në vitin aktual vlerësohen të prodhohen dhe shitin 40.000 njësi Mono-qark dhe 10.000 njësi Bi-qark. Duke gjykuar se do të ishte e përshtatshme të përdorej metoda ABC, kompania ka vlerësuar edhe informacionin e mëposhtëm:

Qendrat e aktiviteteve	Kostot	Indikatori	Mono-qark	Bi-qark
Mirëmbajtja e pjesëve të inventarit	360.000	Numri i pjesëve	300	600
Prokurimi i blerjeve	540.000	Numri i urdherave	2.000	1.000
Kontrolli i cilësisë	1.500.000	Numri i testeve	20.000	30.000
Kosto e mirembajtjes së makinerive		Orë makinerie	2	2

Kërkohet:

(7 pikë)

1. Tregoni koston e prodhimit për njësi të produkteve të kompanisë sipas metodës tradicionale
2. Tregoni koston e prodhimit për njësi të produkteve të kompanisë sipas metodës ABC

Zgjidhje Ushtrimi nr. 1

1. Tregoni koston e prodhimit per njesi te produkteve te konipanise sipas metodes tradicionale

$$K_{\text{coef. rendimit}} = \frac{\text{SHPP}}{\text{oret e punes direkte}} = \frac{3,000,000}{2*40,000 + 1*10,000} = 50 \text{ leke/ore te punes} \quad (0.5 \text{ pikë})$$

Elementet e Kostos	Mono – qark	Bi – qark
Kosto e Materialeve	40	80
Kosto e punes	18	36
ShPP	50*1ore= 50	50*2ore= 100
Kosto e prodhimit/njesi	108	216

(1 pikë)

2. Tregoni koston e prodhimit per njesi te produkteve te kornpanise sipas metodes ABC

$$K_{\text{coef. rendimit miremb.inv.}} = \frac{360,000}{900} = 400 \text{ leke/pjese} \quad (0.5 \text{ pikë})$$

$$K_{\text{coef. rendimit prokur.}} = \frac{540,000}{3,000} = 180 \text{ leke/urdher} \quad (0.5 \text{ pikë})$$

$$K_{\text{coef. rendimit kont. cils}} = \frac{1,500,000}{50,000} = 30 \text{ leke/test} \quad (0.5 \text{ pikë})$$

$$K_{\text{coef. rendimit miremb.mak.}} = \frac{600,000}{2*40,000 + 1*10,000} = 6 \text{ leke/pjese} \quad (1 \text{ pikë})$$

(llog e shpp miremb = 3,000,000 - (360,000+540,000+1,500,000) 0.5p)

Shperndarja e SHPP-ve sipas produkteve (2.5 pikë) (0.5 pke cdo rrjesht I tabelës se meposhtme ose 0.25 p per cdo shifer te llogaritur)

Aktivitet	Mono-qark	Bi-qark	Totali
Mirembajtja e inventareve	300*400=120,000	600*400=240,000	360,000
Prokurimeve	2,000*180=360,000	1,000*180=180,000	540,000
Kontrolli I cilesise	20,000*30=600,000	30,000*30=900,000	1,500,000
Mirembajtje makinerive	2*40,000*6=480,000	2*10,000*6=120,000	600,000
Totali ShPP	1,560,000	1,440,000	3,000,000
Pjestuar nga njesite	/40,000	/10,000	
SHPP / njesi produkti	39	144	

Llogaritja e koston se prodhimit per njesi sipas metodes ABC

(0.5 pikë)

Elementet e Kostos	Mono – qark	Bi – qark
Kosto e Materialeve	40	80

Kosto e punes	18	36
ShPP	39	144
Kosto e prodhimit/njesi	97	260

Ushtrimi 2

Kompania ABA prodhon nje produkt te vetem duke perdorur sistemin e prodhimit te vazhduar. Procesi kalon neper dy departamente. Per muajin Prill kemi marre informacionin e meposhtem per departamentin e pare.

Njesite:	
-Prodhimi ne proces 31 Mars:	3,000 njesi, 100% te perfunduar per Materialet direkte dhe 40% per koston e transformimi.
-Njesi te hyra ne prodhim gjate muajit Prill:	22,000 njesi
-Njesi te perfunduar gjate muajit Prill:	20,000 njesi
-Prodhimi ne proces 30 Prill	5,000 njesi, 100% te perfunduar per MD dhe 25% per kosto transformimi.
Kostot (Leke):	
-Prodhimi ne proces , 31 Mars	
MD	7,500
Kosto transformimi	2,125
-MD te hyra ne prodhim gjate muajit Prill	70,000
-Kosto transformimi gjate muajit Prill	42,500

Kerkohet:

(6 pikë)

- Përcaktoni njësitë ekuivalente për materialet direkte dhe për koston e transformimit, sipas metodës FIFO.
- Llogarisni koston e produkteve të përfunduara dhe të produkteve në proces në fund të periudhës, sipas metodës FIFO

Zgjidhje Ushtrimi nr. 2

1. (3 pikë) (rrjedha natyrore + sasite 1 pikë; njesite ekuivalente nga 1 pikë per 2 rrjeshtat kryesor)

Rrjedha natyrore	Sasia Fizike	Njesi ekuivalente MD	Njesi ekuivalente kosto transformimi
T ₁ Prodh. proc. fillim	3,000		
Njesi te hyra filluan perfunimin	22,000		
Totali	25,000		
Produkt I prefund. Nga:			
- T ₁	3,000	0	(60%*3,000)= 1,800
- Prodh.rrjedhes	17,000	17,000	17,000
T ₂ prodh.proc fund	5,000	5,000	(25%*5,000)=1,250
Totali	25,000	22,000	20,050

Llogaritja e koston per njesi ekuivalente(0.5 pikë per cdo kosto te sakte) 1 pikë

Elementet	totali	Mat. direkte	Kosto transform.
Kosto e T ₁	9,625	-----	-----
Kosto rrjedhese	112,500	70,000	42,500
Totali	122,125	70,000	42,500
		/22,000	/20,050
Kosto/njesi ekuivalente		3.182	2.12

Llogaritja e koston se:

I- Produkti I perfunduar (1.5 pikë):	
-kosto e T ₁	= 9,625
-perpunimi I T ₁ =1,800*2.12	= 3,811
-kosto rrjedhese=17,000*(3.182+2.12)	=90,129
<u> Totali</u>	<u>103,565</u>

II. kosto prodhimit ne process ne fund: (0.5 pikë)

- Material direkte=5,000*3.182=15,910	
- Kosto transform=1250*2.12= 2,650	
<u> Totali</u>	<u>18,560</u>
<u>Kosto totale</u>	<u>122,125</u> (prova e shperndarjes se koston se prodhimit.

Pyetje me alternativa (një pikë secila)

1. Cili nga standardet e mëposhtme do të prodhojë variancën më të MADHE të pafavorshme?

- a) Standardet normale
- b) Standardet praktike
- c) Standardet ideale
- d) Standardet të pritshme

Pergjigja e sakte: alternativa (c)

Cila nga kostot e mëposhtme NUK përfshihet në koston e prodhimit të produktit të gatshëm?

- a) ajri i presuar i makinerive të prodhimit
- b) paga e rojes së repartit të prodhimit
- c) pagesat shtesë që marrin punonjësit e linjës së montimit
- d) amortizimi i ndërtesës së magazinës së produkteve të gatshme

Pergjigja e sakte: alternativa (d)

III. ANALIZA E PASQYRAVE FINANCIARE

(15 PIKË)

Pyetje me alternativa (një pikë secila)

1. Cili nga bizneset e mëposhtme do të ketë ciklin operativ më të shkurtër?
- a) Një dyqan veshjesh me pakicë.
 - b) Një dyqan ushqimor.
 - c) Një prodhues makinash.
 - d) Një shitës makinash.

Pergjigja e sakte: alternativa (b)

Ushtrimi 1

Te dhenat e mëposhtme janë shkeputur nga llogaritë financiare të shoqërisë Globe për vitin ushtrimor 2012:

(3 pikë)

Zerat	Shuma
Shitjet	3.600.000
Shpenzime interesi për obligacionet	120.000
Tatim fitimi	600.000
Fitimi neto	800.000

Kerkohet:

1. Te gjendet sa here është fituar interesi i obligacioneve për vitin 2012.
2. A do të ishte i pershtatshëm ky tregues nga këndvështrimi i bankës për t'iu dhënë kredi kësaj njesie për vitin 2013?

Zgjidhje Ushtrimi nr. 1

1) Te gjendet sa here është fituar interesi i obligacioneve për vitin 2012.

(1.5 pikë)

Llogaritet Fitimi para interesave dhe tatim taksave:

Fitimi neto + tatimi mbi fitimin + shpenzime interesi

$$= 800.000 + 600.000 + 120.000 = 1.520.000 \text{ leke}$$

Llogaritet **Raporti Here interesi te fituar**

$$= \text{Fitimi para interesave e tatim taksave} / \text{Shpenzime interesi} =$$

$$1.520.000 / 120.000 = 12,66 \text{ here}$$

Duhet të saktësohet çfarë shpreh ky raport: Raporti shpreh mundësinë që ka fitimi para interesave e tatim taksave për të mbuluar barrën e borxheve, që në këtë rast përfaqësohet nga shpenzimet e interesit.

2) A do te ishte i pershtatshem ky tregues nga kendveshtrimi i bankes per t'i dhene kredi kesaj njesie ekonomike per vitin 2013? (1.5 pikë)

Meqenese ky raport konsiderohet I pershtatshem si nga ana e njesise ekeonomike dhe nga ana e bankes ne nivelin 6-7 here, do te shpreheshim se raportin e njesise tone Globe 12,77 here banka do ta konsideronte te pershtatshem per t'i na dhene nje kredi per vitin 2013.

Ushtrimi 2

Shoqerite Alfa dhe Oracle operojne ne fushen e ofrimit te programeve kompjuterike, ku Alfa ofron kryesisht programe individuale, kurse Oracle ofron pothuajse ekskluzivisht programe per biznese. Me poshte jepen te dhena te ketyre dy shoqerive per vitet 2010-2012. (4 pikë)

Zerat	2012	2011	2010
<i>Alfa</i>			
Shitjet	36.835	32.187	28.365
Llogari te arketueshme mesatare	5.543	5.163	4.400
Ndryshimi ne shitje nga viti paraardhes	+14.4%	+13.5%	+12.1%
<i>Oracle</i>			
Shitjet	10.156	9.475	9.623
Llogari te arketueshme mesatare	1.965	1.978	2.234
Ndryshimi ne shitje nga viti paraardhes	+7.2%	-1.5%	-11.8%

Kerkohet:

- Llogarisni raportin e qarkullimit te llogarive te arketueshme per Alfa dhe Oracle per vitet 2010-2012.
- Shpjegoni pse ka ndryshime ne normat e qarkullimit te llogarive te arketueshme te ketyre shoqerive gjate periudhes tre vjecare.

Zgjidhje Ushtrimi nr. 2

a. Llogarisni raportin e qarkullimit te LLA per Alfa e Oracle per vitet 2010-2012. (2 pikë)

Raportet e qarkullimit	2012	2011	2010
<i>Alfa</i>			
Qarkullimi LLA (here) = Shitjet / LLA mesatare	6,64	6,23	6,44
QarkullimiLLA (Dite) = 365 / here qarkullimi LLA	55	59	57
<i>Oracle</i>			
Qarkullimi LLA (here) = Shitjet / LLA mesatare	5,16	4,79	4,3
QarkullimiLLA (Dite) = 365 / here qarkullimi LLA	71	76	85

b) Shpjegoni pse ka ndryshime ne normat e qarkullimit te LLA te ketyre shoqerive gjate periudhes tre vjecare. (2 pikë)

Nga llogaritjet rezulton qe Alfa i qarkullon me shpejt LLA te saj ne krahasim me kompanine Oracle. Nje arsye per kete eshte se Alfa ofron programe individuale, ndersa Oracle ofron programe per bizneset.

Me ne detaje shohim se, kompania Alfa I arketon parate e saj cdo 57 dite ne vitin 2010, ka nje rritje prej dy dite me shume ne vitin 2011 (pra nje perkeqesim), por perseri ka nje permiresim ne vitin 2012 prej dy ditesh ne krahasim me vitin 2010. Odersa, Oracle arketonte cdo 85 dite klientet e saj ne vitin 2010, dhe ka permiresim ne vazhdimesi ne vitin 2011 dhe 2012, duke ulur per katesisht me 9 dite e me 5 dite.

Per te gjykuar me mire mbi ndryshimin mes kompanive duhet te shohim ndryshimin e shpejtesise se qarkullimi te lidhur edhe me ritmin e rritjes se shitjeve. Edhe nese e shohim ne kete prizem kompania Alfa eshte duke punuar me mire se ritmi I rritjes se shitjeve te saj psh ne vitin 2012 eshte me I larte(+14,4%) se ritmi i rritjes se LLA (6,9%).

Ushtrimi 3

Jejet informacioni i meposhtem nga pasqyrat financiare per kompanine Prealpina, per periudhen 2011, 2012 ne mln leke. (3 pikë)

	2012	2011
Shitjet	2.801	2.885
Kosto e produkteve shitura	1.969	2.071
Shpenzime interesi	123	110
Mjete monetar e ekuivalente	108	105
Llogari te arketueshme	318	286
Inventare	248	285
Llogari te pagueshme	361	346
Deftesa te pagueshme	50	99

Kerkohet:

Te llogarisni ciklin operativ dhe ciklin e parase dhe te komentoni mbi keta tregues dhe mbi shkallen e likuiditetit te kompanise per te dy periudhat.

Zgjidhje Ushtrimi nr. 3

a. Te llogarisni ciklin operativ dhe ciklin e parase (1.5 pikë)

Raportet	Llogaritjet
Qark Inventareve= $KPSH/Inventare$ mesatare	$1969/(248+285)/2 = 7.39$ here
Dite qarkullimi Inventare = $365/Here$ qark. Inv	$365 / 7.39 = 49.4$ dite

Qark LLA = Shitjet/LLA Mesatare	$2810/(318+286)/2 = 9.27$ here
Dite Qark LLa = 365/here qark LLA	$365/9.27 = 39.4$ dite
Qark LLP = KMSH/LLP mesat	$1969/(3612+346)/2 = 5.57$ h
Dite qark LLP = 365/Here qark Llp	$365 / 5.57 = 65.5$ dite
Cikli Operativ = Dite Mb Inv + Dite mb LLA	$49.4 + 39.4 = 88.8$ dite
Cikli i parase = CO - Dite mb LLP	$88.8 - 65.5 = 23.3$ dite

b. Te komentoni mbi keta tregues dhe mbi shkallen e likuiditetit te kompanise per te dy periudhat. (1.5 pikë).

Duhet te shpjegohet cfare perfaqeson cikli operativ dhe si shprehet: Cikli operativ eshte koha e nevojshme per konvertimin ne para te zerave te aktivitetit, pra shprehet ne dite te qarkullimit te klienteve dhe dite qarkullimi te inventareve Prirja e ketij treguesi duhet te jete drejt shkurtimeve.

Ndersa cikli i parase eshte diferenca mes ciklit operativ dhe diteve te qarkullimit te furnitoreve (LLP). Nese krahasojme ditet e qarkullimit te klienteve me normat e kreditimit te klienteve (2/10, n/30) shohim se te tretet po punojne me parate e kesaj njesie per afersisht 9 dite, ndersa nese normat e kreditimit te furnitoreve jane 2/10, n/60, atehere mund te themi se njesia ka tejrluar afersisht 6 dite kohen e pagimit te tyre.

Ushtrimi 4

Shoqëritë Aquila Liquori dhe Skenderbeu janë të ngjashme dhe operojnë në të njëjtën industri. Skenderbeu filloi aktivitetin në 2010 dhe Aquila Liquori në 2006. Në 2013, të dy shoqëritë paguan 8% interes ndaj kreditorëve të tyre. Disponohet ky informacion: (4 pikë)

	Aquila Liquori			Skenderbeu		
	2013	2012	2011	2013	2012	2011
Qarkullimi aktiveve totale	2.9	2.6	2.8	1.5	1.3	1.0
ROA	8.7%	9.3%	8.5%	5.7%	5.4%	5.1%
Fitimi bruto (%)	2.1%	2.2%	2.0%	2.6 %	2.8%	2.7%
Shitjet (000/lekë)	450.000	420.000	436.000	250.000	210.000	150.000

Krahasoni te dy shoqerite, lidhur me aftësinë e tyre për përdorimin eficient të aktiveve në realizimin e fitimit. Komentoni edhe suksesin e tyre në përdorimin e levës financiare në vitet e dhëna.

Zgjidhje Ushtrimi nr. 4

Raport mbi ecurine e dy shoqerive Skenderbeu e Aquila Liquori per periudhe 2011-2013

Shohim se fitimet bruto te shoqerise Skenderbeu jane me te larta se te Aquila Liquori. Megjithate kjo e dyta ka nje raport te qarkullimit te aktiveve totale ndjeshem me te larte. Si rezultat Aquila realizon nje raport te larte te kthimit te aktiveve (ROA).

Duke studiuar prirjen e te dy kompanive shohim se permiresimi i te gjithe treguesve te dhene tek shoqeria Skenderbeu eshte me i dukshem se sa tek shoqeria Aquila. Keto diferenca mund te vijne nga fakti se Skenderbeu eshte nje kompani e re vetem tre vjecare, ndersa Aquila eshte nje kompani me e vjeter dhe e stabilizuar.

Raportet e larta te qarkullimit te aktiveve te kompanise Aquila, mund te vijne si rezultat I faktit qe aktivet e saj jane blere me heret pra jane me te vjetra. Nese raportet e qarkullimit do te ishin llogaritur me vlerat aktuale, korrente, diferencat mund te ishin me te pakta. por kjo nuk do te zgjase shume. Moshja relative e aktiveve mund te shpjegoje gjithashtu ndryshimet ne raportet e kthimit ne active (ROA). Duke supozuar qe aktivet e kompanise Skenderbeu jane me te reja, ato mund te kerkojne me pak shpenzime per mirembajtje.

Se fundi, kompania Aquila ka perdorur me sukses leven financiare ne vitin 2013. Kthimi ne aktivet totale te saj eshte 8.7% kundrejt 8% qe ishte % e interesit ndaj kreditoreve te saj. ndersa, kompania Skenderbeu ka kthim ndaj aktiveve totale 5,7 % pra, mjaft me te ulet se 8% qe eshte % e interesit qe u paguan kreditoreve.